



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 26/ Prot.
6

Tiranë, më 2/3/2017

REKOMANDIM

Nr. 2, datë 2/3/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "*Trans Adriatic Pipeline AG (TAP), Dega Shqipëri*", Tiranë

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr 16, datë 16/01/2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "*Trans Adriatic Pipeline AG (TAP), Dega Shqipëri*", me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga personat me inicialet V.H dhe H.M, në kuadër të ligjshmërisë së aksesit dhe përpunimit të të dhënave personale në përmbajtje të dokumentit Certifikatë Familjare lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile "Ura Vajgurore", në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga personat me inicialet V.H dhe H.M të cilët pretendonin se kontrolluesi "*Trans Adriatic Pipeline AG (TAP)*" ka aksesuar dhe përpunuar në mënyrë të paligjshme, të dhënat e tyre personale në përmbajtje të dokumentit Certifikatë Familjare lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile "Ura Vajgurore". Ankuesit kanë kërkuar marrjen e masave për hetimin e ligjshmërisë së aksesit dhe përpunimit të të dhënave personale.

1. Zyra e Komisionerit, në kuadër të trajtimit të ankesës, konstatoi se kontrolluesi e ushtron veprimtarinë në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 116/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe *Trans Adriatic Pipeline AG (TAP)*, lidhur me projektin e gazsjellësit *Trans Adriatic Pipeline (Projekti TAP)*, si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe *Trans Adriatic Pipeline AG*, në lidhje me projektin e gazsjellësit *Trans Adriatic Pipeline (Projekti TAP)*", dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë *Trans Adriatic Pipeline AG*, lidhur në datën 24.11.2011, ndryshuar më 10.04.2014.

Në marrëveshjen e bashkëpunimit që kontrolluesi ka nënshkruar me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, parashikohet detyrimi i ZRPP për t'i mundësuar TAP AG, akses të plotë në të gjitha të dhënat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme që ZRPP administron si dhe çdo informacion që ka lidhje me to (arkiva të

pronësisë, regjistrat hipotekare, dosje kompjuterike, etj.) dhe të lejojë TAP AG që të përdorë këto të dhëna me qëllim ndërtimin e *gazsjellësit* TAP.

Zyra e Komisionerit vlerëson se marrëveshja detyron çdo institucion publik për të kontribuar në procesin e përmbushjes së saj në përputhje me kompetencat ligjore përkatëse. Kjo nënkupton edhe ofrimin e aksesit në të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme për realizimin e marrëveshjes.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, përsa i përket ankesës së paraqitur dhe pas analizimit të provave, dokumentacionit dhe bazës ligjore, nuk u konstatuan shkelje dhe se të dhënat personale të palës ankuese janë siguruar në mënyrë të ligjshme nga kontrolluesi TAP.

2. Nga analizimi i kontratave që TAP lidh me individë të ndryshëm dhe dokumentacionit që plotësohet për lidhjen e një kontrate shitblerje, rezulton se kontrolluesi nuk i informon subjektet e të dhënave personale (personat me të cilët nënshkruan kontrata), mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar;

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për informim u jep mundësi subjekteve të të dhënave që të njihen me mënyrën e përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe të drejtat që gëzojnë. Kjo përbën një garanci më tepër për ushtrimin e këtyre të drejtave.

3. Nga analizimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë (në cilësinë e kontrolluesit) dhe kompanisë Trans Adriatic Pipeline AG (në cilësinë e përpunuesit), lidhur në datën 24.11.2011, ndryshuar më 10.04.2014, rezulton se nuk janë parashikuar rregulla mbi garantimin e sigurisë teknike, organizative dhe konfidencialitetit të të dhënave personale që përpunohen dhe rregulla mbi garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Parashikimi i këtyre rregullave është thelbësor për të garantuar sigurinë e të dhënave dhe përpunimin e ligjshëm nga ana e kompanisë **Trans Adriatic Pipeline AG** (në cilësinë e përpunuesit). Kjo kontratë përbën një garanci më shumë për subjektet e të dhënave.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ (që mban datën 15.02.2017). Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Kontrolluesi ka sjellë pretendimet e tij të cilat i ka paraqitur me shkrim në shkresën e datës 27.02.2017 dhe ku citohet:

"TAP konfirmon pozicionin e tij për të siguruar kujdesin maksimal për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të BE-së dhe praktikën më të mirë".

Kontrolluesi është angazhuar në plotësimin e detyrimeve ligjore sipas konstatimeve të grupit të kontrollit. Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit, i cili ka qenë i ndërsjellët në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30, 31 pika 1/ "a/1" dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të merren masa për të përfshirë detyrimin për informim në të gjitha kontratat që lidhen me subjektet e të dhënave. Gjithashtu, kontrolluesi të marrë masa për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën “Politikat e Privatësisë” sipas opinionit të Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat.”
2. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, të parashikohen rregulla mbi garantimin e sigurisë teknike, organizative dhe konfidencialitetit të të dhënave personale që përpunohen dhe rregulla mbi garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit;
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjorbë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 2 / 3 /2017

